



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2020:037735
Datë: 15.03.2024
Numri i dokumentit: 05456057

E.nr.683/23

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, me gjyqtarin Faton Ajvazi, me bashkëpunëtorin profesional Besart Selmani duke vendosur në lëndën e përmbarrimit të kreditorës N.M.H. nga Ferizaj të cilët i përfaqëson Av. Fadil Sinanaj nga Gjilani, kundër debitorit Spitali i përgjithshëm - Ferizaj, për pagesën e pagave jubilarë dhe shpenzimet e procedurës, më datë: 15.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDON procedura përmbarrimore në lëndën E.nr.683/23, për shkak të përmbushjes së kërkesës së kreditorit.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.683/23, të datës 15/05/2023, e ka caktuar përmbarrimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorëve kundër debitorit Spitali i përgjithshëm - Ferizaj, për pagesën e borxhit dhe shpenzimeve të procedurës, në bazë të Aktgjykimit: 544/20, të datës 28/08/2020.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përmbarrimit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimin e datës 01/09/2023, e ka urdhëruar Thesarin e Kosovës pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe të Transfereve, që nga llogaria e debitorit ta transferoj shumën e përgjithshme të mjeteve prej 1,465.26euro, në llogarinë e të autorizuarit të kreditorës.

Meqenëse kreditorja e ka realizuar kërkesën e saj, Gjykata konstatoj se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66, par 4, të LPP-së dhe vendosi që ta përfundoj procedurën përmbarrimore në këtë çështje juridike përmbarrimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

E.nr.683/23, më datë 15.03.2024

GJYQTARI
Faton Ajvazi